



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA BERAT

RELACION
PER MIRATIM IN E TAVANEVE PER FUNDIMTARE TE SHPENZIMEVE PER
PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESEM 2019-2021

Te nderuar keshilltar!

Ne zbatim te Ligjit nr. 68/2017 "Per financat e vetëqeverisjes vendore", neni 36, Programi buxhetor afatmesëm vendor, Bashkia Berat përgatiti fazën e pare te Planit Buxhetor Afatmesem 2018-2020 dhe miratoi materialin ne mbedhjen e Këshillit Bashkiak ne muajin qershor 2018(brenda afatit ligjor.

Neni 37 citon: Bazuar në vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të përditësuara të të ardhurave dhe transfertave nga Buxheti i Shtetit, të përcaktuara në udhëzimin plotësues të përgatitjes së buxhetit vendor të Ministrisë së Financave, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatiti dhe paraqet për miratim në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi.

Ne zbatim te Udhëzimit te Ministrit te financave dhe Ekonomise, nr 23 date 30.07.2018,"Per procedurat standarte te pergatitjes se pogramit buxhetor afatmesem te njesive te qeverisjes vendore", ardhur nga MFE me shkresen nr. 14423/1 date 30.07.2018, protokolluar me tonen nr. 5086 date 08.08.2018, Bashkia Berat përgatiti tavanet përfundimtare te PBA 2019-2021, duke respektuar edhe fazat e Kalendarit buxhetor 2019-2021, miratuar nga Keshilli Bashkiak.

Tavanet përfundimtare te PBA 2019-2021 jane përgatitur bazuar ne instrumentin e planifikimit te financiar dhe ndarjes ne nenfunsione sipas modelit te riderguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomise.

Ministria e Financave me shkresen Nr.11714 ,date 19.06.2018 "Dergohen mendimet mbi PBA 2019-2021", drafti I pare, ka dhene mendime te cilat po i rendisim se bashku me reflektimet dhe shpjegimet e administrates se bashkise: (Shkresa e mesiperme u dergua keshillit Bashkiak I cili e shqyrtoi ne mbedhjen e muajit Qershor 2018.

A. Vështrim i Përgjithshëm.

Nga vështrimi i Relacionit shpjegues te Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2019-2021 (shtojca 2) të Bashkisë Berat vërejm se, ne procesin e përgatitjes se Programit Buxhetor Afatmesëm,

Bashkia Berat ka marrë vendime të rëndësishme ne nivel strategjik dhe buxhetor, duke i përkthyer ato ne tavane shpenzimesh. Për t'i paraprire problemeve dhe nevojave të vecanta të komunitetit, Bashkia Berat ka parashikuar ndërhyrje me politika publike të cilat kanë si objektiv specific ,rivitalizimin e qendrave të njësive administrative, restaurimi te zonës historike, me infrastrukturën e nevojshme për krijimin e dy qendrave ekonomike rajonale, mbështetje të ofrimit të shërbimit tregetar ,hotelier dhe informative për turistët, ofrimi i hapësirave rekreative dhe argëtuese modernizimi i sherbimeve publike te ofruara për banorët dhe turistet ne zonat e mbrojtura historike.

Parashikimet afatmesme te shpenzimeve buxhetore për politikat ekzistuese, për zhvillimin e ekonomisë kryesisht bujqësia dhe turizmit si dhe mbrojtjen e mjedisit, si parkun kombëtar të Tomorit dhe mjedise të tjera natyrore me florë dhe faunë shumë të pasur duke i kthyer në mundësi punësimi dhe zhvillimi ekonomik per Beratin. Iniciativat për politika të reja i refrohen kostove shtesë që vijnë nga ofrimi i produkteve/shërbimeve të reja,në infrastrukturën e tregeëtis duke krijuar kushte te tregetimit të produkteve të ndryshme,urbanizimin e kontrolluar të qendrave ekzistuese,shfrytëzimin e drejtë të hapsirave publike dhe orientimin drejt zonave urbane zhvillimin, zbutjen e pabarazive sociale.

Për cdo ndërhyrje Bashkia Berat ka zhvilluar një program buxhetor për të cilin ka identifikuar burimet që do të përdoren për të realizuar projektet.Të gjitha vendimet kryesore për financimin e politikave janë marrë duke analizuar arritjet e viteve te kaluara; vlerësimin real të burimeve; sigurimin e një zhvillimi te integruar tertorial te Bashkisë mbi bazë te Planit te Pergjithshëm Vendor dhe Strategjisë së Zhvillimit të Përgjithshëm.

Me qëllim sigurimin e fondeve të nevojshme buxhetor për politika të reja me përparësi të lartë,mund te aplikohen përdorimi me kursim i fondeve duke ofruar të njëjtat produkte kundrejt një kostoje më të ulët, që rezultojn me një eficencë të lartë të përdorimiit të burimeve.Kur hapësira fiskale për politikat e reja është e kufizuar, mbështetur në kontekstin makroekonomik, kusimet prej eficencës mund të përdoren për të financuar përparësitë kryesore strategjike te bashkisë.Alternativë për rritjen e efektivitetit dhe eficencës së përdorimit të fondeve është dhe planifikimi i fondeve për ato projekte investimesh të cilat janë pjesë e Planit te Pergjithshëm Vendor dhe Strategjisë së Zhvillimit të Përgjithshëm , të mundura për t'u realizuar duke ulur nivelin e fondeve të trashëguara dhe duke rritur mundësinë e financimit të projekteve me rëndësi strategjike.

B. Programet buxhetore të Njesisë së vetëqeverisjes vendore

- Organet ekzekutive dhe legjislative,cështjet financiare dhe fiskale
- Shërbimet e përgjithshme
- Shërbimet policore
- Shërbimet e mbrojtjes nga zjarri
- Çështje të përgjithshme ekonomike, tregëtare dhe të punës
- Bujqësia, pyjet, peshikim dhe gjuetia
- Transporti
- Industritë e tjera
- Menaxhimi i ujërave të zeza
- Mbrojtja e mjedisit
- Zhvillimi i strehimit

Zhvillimi i komunitetit
Furnizimi me ujë
Shërbimet ambulatorë
Shërbimet rekreative dhe sporti
Shërbimet kulturore
Arsimi bazë dhe parashkollor
Arsimi i mesëm
Sëmundjet dhe paaftësia
Të moshuarit
Familje dhe fëmijët
Papunësia
Strehimi
Ndihma ekonomike

C. Komente të Përgjithshme

- Projektdokumenti i Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021, të Bashkisë Berat është përgatitur ne Instrumentin e Planifikimit Financiar (FPT);
- Bashkia Berat ka respektuar afatin ligjor të paraqitjes së projektdokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm, të përcaktuar ne ligjin 68/2017 “Per financat e njësisve të vetëqeverisjes vendore”, si dhe Udhëzimit Plotësues Nr. 6/1, datë 28.02.2018, “Për përgatitjen e buxhetit vendor”, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, në vijim udhëzimi plotësues.
- Raportet e projektdokumentit të PBA-së, dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, janë sipas formateve të përcaktuara ne udhëzimin plotësues;
- Bashkia Berat ka paraqitur relacionin shpjegues për procesin e përgatitjes të programit buxhetor afatmesëm , sipas Shtojcës 2, Programi Buxhetor Afatmesëm 2019-2020, të udhëzimit plotësues, të gjitha rubrikat nuk janë plotësuar.

D. Analiza e të ardhurave buxhetore

Bashkia Berat në planifikimin e të ardhurave është mbështetur në realizimin faktik të të ardhurave të vitit 2017. Tabela: Burimet Buxhetor (Instrumenti i Planifikimit Financiar)

Gjatë vitit 2017 ka realizuar të ardhurat nga burimet e veta 371 279 mijë lekë, (përfshirë të ardhurat e trashëguara nga viti i kaluar, 2016); të ardhurat të përgjithshme 1 301 931 mijë lekë (të ardhurat e veta + transfertat e qeverisjes qendrore).

Tendenca e rritjes së të ardhurave:

- Të ardhurat nga burimet e veta, **per vitin 2018** janë planifikuar me një rritje prej 35.9% ,nga fakti i vitit 2017. Raporti I të ardhurave nga taksat dhe tarifat ndaj totalit të të ardhurave të përgjithshme parashikuar të jetë 26.6% në vitin 2019; 26.5% në vitin 2020; 26.3% në vitin 2021.
- **Për vitin 2019** të ardhurat nga burimet e veta janë parashikuar me një rënie prej 0.6% në krahasim me pritshmëritë e vitit 2018, ku të ardhurat nga taksat do të zënë 42.4% të të ardhurave të veta dhe janë parashikuar me një rritje prej 3% në krahasim me të ardhurat nga taksat e vitit

2018,të ardhurat nga tarifat do të zënë 34.7% të totalit të të ardhurave të veta dhe janë parashikuar me një rritje prej 2.1%.

- **Për vitin 2020** të ardhurat nga burimet e veta janë parashikuar të rriten 2.9% në krahasim me pritshmëritë e vitit 2019, ku të ardhurat nga taksat do të zënë 42.4% të të ardhurave të veta dhe janë parashikuar me një rritje prej 3% në krahasim me të ardhurat nga taksat e vitit 2019, të ardhurat nga tarifat do të zënë 34.7% të totalit të të ardhurave të veta dhe janë parashikuar me një rritje prej 3%.
- **Për vitin 2021** të ardhurat nga burimet e veta janë parashikuar të rriten me 2.9% në krahasim me pritshmëritë e vitit 2020. Të ardhurat nga taksat do të zënë 42.4% të të ardhurave të veta dhe janë parashikuar me një rritje prej 3% në krahasim me të ardhurat nga taksat e vitit 2020, të ardhurat nga tarifa do të zënë 34.7% të totalit të të ardhurave të veta dhe janë parashikuar me një rritje prej 3%.

Referuar parashikimit të të ardhurave të veta, pas rënies së parashikuar në vitin e parë të PBA-së vërejmë rritjen në nivelin 2.9% të të ardhurave të veta në dy vitet e ardhshme . Ndikimi pozitiv në rritjen e të ardhurave nga taksat është llogaritur constant prej 3% në të gjithë zërat. Nuk kanë parashikuar taksa me ndikim negative në të ardhurat. Bashkia Berat ka planifikuar 2 taksa të perkohshme.

Ndikimi negativ në të ardhurat nga tarifat kanë të ardhurat nga tarifa e shërbimit zjarrefikesve ka një rënie prej 73.5%, janë parashikuar me rënie dhe të ardhurat nga qeraja e aseteve me një rënie prej 21%.

Të ardhurat nga transferta e pakushtëzuar është planifikuar në vlerën e transfertës së përcaktuar në udhëzimin plotësues dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 25, datë 17.01.2018, “Për miratimin e kuadrit makroekonomik e fiskal për periudhën 2019-2021 (VKM 25/2018).

Rekomandojmë që bashkia duhet të parashikojë dhe të ardhurat që vijnë nga taksat mbi të ardhurat personale.

Rekomandojmë që titujt e taksave të perkohshme të kenë titujt e projekteve për të cilat ato vendosen në bazë të ligjit 68 / 2017.

Analiza e Shpenzimeve buxhetore

Në dokumentin e PBA-së të Bashkisë Berat shpërndarja e burimeve është realizuar mbi bazë programi buxhetor dhe totali i tavaneve të shpenzimeve është brënda kontekstit të të ardhurave të parashikuara.Parashikimi buxhetor është i balancur.Bashkia Berat ka planifikuar fondin rezervë dhe fondin e kontigjences.Tabel:Shpenzimet sipas programeve (IPF).

Referuar Formatit “Parshikimi i shpërndarjes së shpenzimeve sipas programeve për njësinë e vetëqeverisjes vendore”;Formati “Investime afatmesme në nivel programi”: Formatit “Kërkesat shtesë të programit buxhetor afatmesëm”, dhe Formatit “Shpenzime sipas funksionit”, të Instrumentit të Planifikimit Financiarë (IPF) vërejmë se shpenzimet e përgjithshme të vitit 2018 janë planifikuar me një rritje prej 37.6% në krahasim me faktin e vitit 2017.Shpenzimet e përgjithshme janë parashikuar në vitin 2019 me një rënie prej 20% në krahasim me planin e vitit 2018,në vitin 2020 me një rënie prej 3.3% ndaj 2019; në vitin 2021 me një rritje prej 4% ndaj vitit 2020. Në parashikim e shpenzimeve për programin “Çështje të përgjithshme ekonomike,tregëtare dhe të punës”, vërejmë se është parashikuar që kostoja e shërbimit të mbulohet me tarifat e shërbimit dhe përsëri të ketë një gjëndje suficit.Në programin “Shërbime të përgjithshme” vërejmë suficit, si dhe vërejm se për shërbimet që bashkia ka

vendosur tarifa të ardhurat nga këto tarifa nuk janë adresuar në programet buxhetore që ofrojnë këto shërbime.

Rekomandojmë që tarifat e shërbimeve të evidentohen në programet buxhetor që ofrojnë këtë shërbim, për të analizuar procesin e balancimit të kostos me tarifën e shërbimit, vëreni Formulari F4 të IPF.

Rekomandojmë të argumentohet në relacion shoqërues se cilat janë arsyet e parashikimit të shpenzimeve totale me një tendencë në rënie në vitin e parë dhe një rritje në vitin e dytë dhe të tretë, por që rezultojnë me një rënie prej 13.1% në krahasim me planin e vitit 2018.

Shpenzimet e personelit (600 + 601)

Shpenzimet e personelit ne vitin 2019 parashikohet të zënë 34.9% ndaj totalit të shpenzimeve të parashikuara për këtë vit; në vitin 2020 parashikohet të zënë 34.3% ndaj totalit të shpenzimeve të parashikuara; në vitin 2021 parashikohet të zënë rreth 33.7%. Numri I punonjësve të njësisë është parashikuar i pa ndryshueshëm për të tre vitet gjithësej 703.

Shpenzimet Operative (602 – 606).

Shpenzimet operative ne vitin 2019 parashikohet të zënë 82.3% ndaj totalit të shpenzimeve të parashikuara për këtë vit; në vitin 2020 parashikohet të zënë 81.8% ndaj totalit të shpenzimeve të parashikuara; në vitin 2021 parashikohet të zënë rreth 80.8%. *Vërerjme se totali i shpenzimeve operative ndaj totalit të shpenzimeve është shumë i lartë.*

Shpenzimet për Investime (230 – 231)

Shpenzimet për Investime ne vitin 2019 parashikohen të zënë 17.7% të totalit të shpenzimeve të parashikuara; në vitin 2020 ato zënë rreth 18.2% të totalit të shpenzimeve të parashikuara për këtë vit, dhe në vitin 2021 rreth 19.2%. Në vitin 2019 shpenzimet për investime janë parashikuar me një rritje prej 4.9% në krahasim me vitin 2018, në vitin 2020 rriten 6.4% ; në vitin 2021 me një rënie prej 27.8%.

Shpenzimet për investime në totalin e shpenzimeve duhet të kenë një peshë specifike më të lartë për të garantuar një zhvillim të qëndrueshëm të njësisë dhe konsolidimin e pozitës fiskale.

E. Disa nga Projektet prioritare të investimeve në periudhën afatmesme

1. Sistemim, asfaltim dhe shtrim rrugesh me beton, mirëmbajtje, tombino e mureve mbajtës në njësiti administrative dhe lagjet e qytetit.
2. Reabilitim i kanaleve ujitës Sinja.
3. KUZ Lapardha, Drobonik.
4. Ndërtim Ujësjellesi fshati Qereshnik, Duhanas.
5. Rikonstruksion i palestreës së gjimnastikës, boksit.
6. Rikonstruksion I shkolles “1 Maji”.
7. Ndërtim cerdhe në Uznovë.

F. Detyrimet e prapambetura

Rekomandojmë që në relacion shoqërues të jepet një përshkrim mbi detyrimet e konstatuara dhe të papaguara, si dhe informacionin mbi likuidimin sipas planifikimit të shlyerjeve.

H. Rreziqet financiare dhe fiskale të bashkisë

Bashkia Berat ka evidentuar resqet fiskale në realizimin e të ardhurave. Të ardhurat janë përlogaritur duke vlerësuar rritjen e bazës së taksueshme, evidentimin e subjekteve mospagues, dhe regjistruar subjektet e reja duke përmisuar procedurat dhe rritur mirëadministrimin e taksave. i të ardhurave është realizuar bazuar në të dhënat historike. Duke ndjekur metodologjinë e IPF (Instrumenti i Planifikim Financiar), përlogaritja e të ardhurave të veta merr parasysh ndikimin e rritjes ekonomike, të rritjes së popullsisë, ndryshimet rregullatore, e nivelit të taksave dhe shfrytëzimin e përmisuar të potencialit të taksave. të ardhurat nga qeveria qendrore, përlogaritja është bazuar në VKM 25/2018 dhe Udhezimit plotësues.

I. Rekomandime nga MFE

Roli kryesor i PBA-së është që të sigurojë që politika, objektivat dhe qëllimet të jenë të përcaktuara qartë dhe se programet dhe produktet e synuara do të arrijnë objektivat dhe qëllimet e politikës në një mënyrë që krijon një përdorim ekonomik eficient dhe efektiv të fondeve buxhetore në një proces vashdimësie. Qëllimet dhe Objektivat duhet të jenë në përputhje me dokumentet strategjike të zhvillimit të planifikuar dhe të planifikimit të politikave të njësisë së vetëqeverisjes vendore. PBA është i vetmi instrument që bën të zbatueshem planin strategjik të zhvillimit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet planifikimit dhe menaxhimit të financave vendore për një periudhë trevjeçare.

Vlerësojmë projektdokumentin e hartuar nga Bashkia Berat duke e kthyer këtë proces në një proces gjithëpërfshirës.

Rekomandojmë, plotësimin e të gjitha rubrikave të formatit relacioni shpjegues (shtojca 2) si dhe për cdo program buxhetor të përcaktohet qëllimi i programit, objektivat dhe produktet që parashikohen të arrihen, produktet duhet të jenë të matshëm dhe të llogaritet kostot për secilin produkt.

Në parashikimin e kërkesave buxhetore për cdo program buxhetor, ku rezulton se ka detyrime të papaguara dhe njësi ka parashikuar në planin e shlyerjes likuidimin e detyrimit ose një pjesë të tij, fondin për shlyerjen e detyrimeve të konstatuara dhe të papaguara, duhet të jenë pjesë e kërkesës buxhetore për programin dhe të pasqyrohet në relacion vlerën e detyrimit që do të likojdohet si dhe në secili zë të shpenzimeve të programit buxhetor është përfshirë vlera e detyrimit që do të likujdohet.

Në parashikimin e shpenzimeve për investime njësi e vetëqeverisjes vendore duhet të ndjek politikën e rritjes së shpenzimeve për investime ndaj totalit të shpenzimeve për të krijuar premise për një zhvillim të qëndrueshëm dhe përdorimin me efektivitet dhe eficiency të fondeve publike.

Argumentimet dhe reflektimet e administratës së Bashkisë:

Analiza e të ardhurave buxhetore, Tendencat e rritjes së të ardhurave:

Për vitin 2019 të ardhurat nga burimet e veta janë parashikuar me një rënie prej 0.6% në krahasim me pritshmëritë e vitit 2018 për keto arsye;

- a) **Ndikimi negativ është në të ardhurat nga tarifatat e shërbimit zjarrefikesve** ka një rënie prej **73.5%**, pasi në pritshmëritë vitit 2018 janë planifikuar të ardhurat nga shërbimi zjarrefikes te

kryer ne Bashkine Ura Vajgurore (1181 000 leke bruto,), dhe ndaj Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Berat, (1 100 000 leke bruto), Ne zbatim te VKB nr.28 date 19.03.2018 Mbi planifikimin e te ardhurave nga sherbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi si dhe perdorimi i tyre per vitin 2018, mbështetur në ligjin nr. 152/2015 “Për sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi”, VKM nr. 285 date 27.06. 2002 “Per tarifat qe kryen MZSH –ja ndaj shtetasve dhe personave juridik e fizik, vendas dhe te huaj”, pika 6 dhe 7 .

b) Janë parashikuar me rënie dhe **të ardhurat nga qeraja e asetëve me një rënie prej 21%.**

Ne zbatim te VKB nr 30 date 19.03.2018 “Per miratimin e planit financiar (te ardhura dhe shpenzime) te banesave sociale për vitin 2018 dhe levrimi i fondeve nepermjet deges se thesarit” ne shumen **20 069 399** leke te cilat detajohen :

- Te ardhura nga qiraja e banesave sociale (Ndertesa) planifikuar per vitin 2018 ne Shumen 3,986,088 leke .
- Te ardhura nga fondet te depozituara ne llogarine e posacme prane bankes se nivelit te dyte ne Shumen 16 083 311 leke .
- Te ardhura nga interesat e depozitave te mjeteve monetare per qerate e banesave sociale, pas perfundimit te afatit dyvjecar te depozites ne Shumen **414000** leke.

Analiza e Shpenzimeve buxhetore :

Rekomandimi I MFE : të argumentohet në relacion shoqërues se cilat janë arsyet e parashikimit të shpenzimeve totale me një tendencë në rënie në vitin e parë dhe një rritje në vitin e dytë dhe të tretë, por që rezultojnë me një rënie prej 13.1% në krahasim me planin e vitit 2018 ,

sqarojme se PBA paraqitetet I ballancuar, pra plani I te ardhurave I barabarte me planin e shpenzimeve. Ashtu sikurse kemi shpjeguar me lart plani I te ardhurave ne vitin 2019 eshte me I ulet se plani I viti 2018, per rrjedhoj dhe plani I shpenzimeve eshte me I ulet.

Administrata e bashkise do te reflektoj ne lidhje me vërerjen **se totali i shpenzimeve operative ndaj totalit të shpenzimeve është shumë i lartë**, ne hartimin e planit te detajuar te shpenzimeve operative gjate parashikimit te vitit 2019, duke vleresuar maksimalisht kryerjen e atyre shpenzimeve operative me te domosdoshme, minimizuar shpenzimet administrative dhe eliminuar shpenzimet jo productive , nisur nga fakti I 8- mujorit dhe pritshmeria e vitit 2018, jo vetem per aparatit administrative te bashkise por edhe te njesive shpenzuese:

Shpenzimet për investime në totalin e shpenzimeve duhet të kenë një peshë specifike më të lartë për të garantuar një zhvillim të qëndrueshëm të njësisë dhe konsolidimin e pozitës fiskale, kjo moto do te shoqeroj punen tone gjate hartimit te detajuar te Plan buxhetit te vitit 2019, duke adresuar edhe problematikat e dala nga degjesat publike te zhvilluar gjate fazes se pare te diskutimit te Draftit PBA 2019-2021.

Per te finalizuar procesin dhe per te pergatituar draftin e rishikuar u hartua plani I masave dhe veprimi ku jane te percaktuar aktivitetet qe do te zhvillohen, afati, personat pergjegjes. Ky plan masash dhe veprimi eshte bere ne perputhje me kerkesat e Ligjit nr. 68/2017 "Per financat e vetëqeverisjes vendore", ligjit 139/2015 “Per veteqeverisjen vendore”, Ligjin 9936 date 26.06.208 “Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise”.

Plani I veprimit, procsverbalet e degjesave publike si dhe lista e pjesmarreseve jane pjese e dokumentave te pergatitjes dhe miratimit te PBA 2019-2021.

U aplikuan degjesat publike, konsultimet me komunitetin duke tërhequr mendimet e sygjerimet e tyre.

Bashkia Berat ne periudhen korrik- gusht zhvilloi dëgjesat publike me lagjet Nr.1.2.3 të Bashkisë Berat, Njësiti administrative Otlak , Sinje, Velabisht, Roshnik, me grupet e interesit, dhe Komisionin Qytetar, duke kryer keto aktivitete:

Aktiviteti nr. 1 : Organizimi I degjesave publike me komunitetin ne lagjet e qytetit dhe njesite administrative.

Aktiviteti nr. 2 Organizimi I degjesave publike me grupet e interesit; komisionin qytetar,

Aktiviteti nr. 3 Zhvillim i degjesave publike me komunitetin ne lagjet e qytetit , njesite administrative dhe grupet e ineteresit:

Aktiviteti nr. 4 Miratimi i dokumentit te rishikuar te PBA 2019-2021.

1. Pergatitja e materialit te rishikuar te Programit Buxhetor Afatmesem 2019 -2021 , Miratimi ne Keshillin Bashkiak

2. Dergimi i materialit ne Ministrine e Financave, brenda 15 shtatorit 2017.

Propozimet e terhequra nga komuniteti dhe grupet e interesit u percollen njesive shpenzuese te vartesise se bashkise per ti integruar ne programet perkatese buxhetore, sipas listimit te prioriteteve brenda mundesive financiare.

Paraqesim me poshte problematikat te marra nga raporti permbledhes I pergatitur nga organizimi I degjesave ne cdo njesi administrative, lagjet e qytetit dhe grupet e ineteresit dhe komisioni qytetar:

1. KOMISIONI QYTETAR:

- Të rishikohet çështja e shpenzimeve joproduktive;
- Të rishikohet çështja e pastrimit të qytetit, pasi derimë tani paraqet një perceptim jopozitiv në sytë e banorëve, por edhe të vizitorëve;
- Vëmendja të mos përqëndrohet vetëm në Qendrën Historike të qytetit, por të shihen me përparësi edhe lagjet e tij periferike.

KËRKESAT E BANORËVE NË MËNYRË TË PËRMBLEDHUR:

- Përmirësimin e infrastrukturës rrugore në akset kryesore e dytësore të Lagjeve dhe Njësive Administrative;
- Përmirësimin e rrjetit të ujësjellës - kanalizimeve;
- Furnizimin me ujë të pijshëm duke reduktuar kufizimet e duke përmirësuar rrjetin e shpërndarjes;
- Zgjdhjen e problemit të rrugëve në parcelat bujqësore;
- Vënien në funksion të plotë të kanaleve kulluese dhe vaditëse në disa prej Njësive Administrative;
- Krijimin e këndeve çlodhëse, argëtuese dhe sportive në zona të ndryshme të territorit të Bashkisë;
- Funksionimin e rrjetit të ndriçimit atje ku ky rrjet ekziston;
- Përmirësimin e infrastrukturës në çerdhe, kopshte dhe qendra shëndetësore.

Propozimet e terhequra nga komuniteti dhe grupet e interesit u percollen njesive shpenzuese te vartesis se bashkise per ti integruar ne programet perkatese buxhetore, sipas listimit te prioriteteve brenda mundesive financiare. Me tej sipas afateve ligjore do te procedojme me pergatitjen e Dokumentit Final te PBA 2019-2021 dhe Plan Buxhetit te vitit 2019, te cilin do te shqyrtojme, diskutojme dhe miratojme ne Keshiilin Bashkiak brenda muajit dhjetor 2018.

Bashkelidhur Tavanet Perfundimtare te PBA 2019-2021, pergatitur bazuar ne instrumentin e planifikimit te financiar dhe ndarjes ne nenfunsione sipas modelit te riderguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomise.

Faleminderit per bashkepunimin!

KRYETARI I BASHKISË

Petrit SINAJ

DREJTORE FINANCES

Luiza BAZAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

PROJEKT –VENDIM
PER MIRATIM IN E TAVANEVE PERFUNDIMTARE TE SHPENZIMEVE PER
PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESEM 2019-2021

Kryetari i Bashkise Berat pasi u njoh me materialin, Programi Buxhetor Afatmesem (i rishikuar) 2019-2021 , ne mbështetje te Ligjit nr.9936 date 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republikën e Shqipërisë”, te ndryshuar , UMF nr.6/1 date 28.02.2018 “Per pergatitjen e buxhetit vendor”, ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “ Per financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 33, 38 , Udhezimit te Ministrit te Financave dhe Ekonomisë, nr. 23 date 30. 07.2018,”Per procedurat standarte te pergatitjes se pogramit buxhetor afatmesem te njesive te qeverisjes vendore”, Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 41, neni 54 gërma dh , neni 64 gërma c,

PROPOZON:

1. Te miratoj Tavanet Perfundimtare te shpenzimeve per programin buxhetor afatmesem 2019-2021 hartuar sipas Instrumentit te Planifikimit Ffinanciar pasqyra D1, bashkelidhur.
2. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Grupi për Menaxhim Strategjik.

KRYETARI I BASHKISË

Petrit SINAJ

Ky projekt-vendim u pa dhe ka bazueshmëri ligjore .

P/SEKTORIT JURISTE

SEKRETARE E KESHILLIT BASHKIAK

Nertila KADËNA

Ledina GJOROVENI